



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA HIMARË

DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR
PROCEDURËN E HAPUR
PUNË PUBLIKE¹²

“NDËRTIMI I PEDONALES SPILE SARAÇINKO”

¹Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti /enti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit public nëf uqi

²Seti I Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.

NJOFTIME

NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti kontraktor, nëse aplikohet)

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri _____

Adresa _____

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

Institucioni i pavarur

☐☐

Njësi e autoriteteve vendore

Të tjera

X ☐

☐

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të
veta

Organ Qendror blerës

Ofrues shërbimi

X ☐

☐

Publik ☐ Privat ☐

I deleguar

Të tjera

☐☐

1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: Orest Vela

Tel/faks _____

E-mail orest.vela@himara.gov.al

1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45246500-8 Punime ndërtimi për shëtitore ; 71000000-8 Shërbime arkitektonike,inxhinierike,ndertimi dhe inspektimi

1.6 Lloji i procedurës së prokurimit:E hapur

1.7 Tipi i kontratës: Punë

1.8Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor (në rastin e

marrëveshjeve *kuadër* *ose* *kontratave*
shumëvjeçare): _____

1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër : _____

1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve) nëse përdoren:

1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:

1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:

1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____

NJOFTIMI I KONTRATËS
(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri:	Bashkia Himarë
Adresa:	Rr. "25 Marsi", nr.2; Spile, Himarë
Tel/Faks:	039322355/039322533
E-mail:	info@himara.gov.al
Adresa e ueb-faqes:	www.himara.gov.al
Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail)	orest.vela@himara.gov.al

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror	Institucioni i pavarur
☐	☐
Njësi e autoriteteve vendore	Të tjera
X	☐

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta X I deleguar ☐	Organ Qendror blerës Ofrues shërbimi ☐ Publik ☐ Privat ☐ Të tjera ☐
---	---

1.4.Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po ☐ Jo ☒

1.5 Kontrate që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po ☐ Jo ☒

1.6 Kontratë e rezervuar :

Po ☐ Jo ☒

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Ndërtimi i pedonales Spile-Saraçinko”

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-96684-08-19-2026

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45246500-8 Punime ndërtimi për shëtitore ; 71000000-8 Sherbime arkitektonike,inxhinierike,ndertimi dhe inspektimi

2.3Lloji i “Kontratës për punë publike”

Realizimi
i
punimeve

☐

Projektimi dhe realizimi i punëve

☒

2.3.1Mënyra e prokurimit

Punime
me matje

☐

Kontratë me çelësa në dorë

☒

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po ☐ Jo ☒

2. 5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik ☐

Me disa Operatorë Ekonomikë ☐

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po☐Jo ☐

2. 6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

--

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ____ (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

--	--	--

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: (këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : “Ndërtimi i pedonales Spile Saraçinko”

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **500,000,000 (pesëqindë milion lekë) pa TVSH**, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Himarë, i ndarë në tre vite financimi, konkretisht:

- **Viti 2026 166,666,667** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) **pa tvsh.**
- **Viti 2027 166,666,667** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) **pa tvsh.**
- **Viti 2028 166,666,666** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë) **pa tvsh.**

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është** _____ (**Monedha**), **pa TVSH** ____

3. Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Himarë miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.64 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2026”, si dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 përfundimtar.

4. Kodi Output: _____

5. Tipi:

InvestimeX

Kodi: **231**

Vlera: **500,000,000**

Shërbime ☐

Kodi: _____

Vlera: _____

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj 24 (njëzetë e katër) ose ditë □□□

Ose

Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

Afati i kryerjes së investimit është 20 (njëzetë) muaj dhe 4 (katër) muaj për realizimin e projektit.

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: ____ ose ditë: ____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)

Ose fillon më ____/____/____ (d/m/v)

mbaron më ____/____/____ (d/m/v)

2.12 Vendndodhja e objektit të kontratës:

Spile, Himarë

2.13 Ndarja në Lote:

Po

☐

Jo

X

Nëse po,

2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1. _____

2. _____

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

☐ një Lot,

☐ disa Lote,

☐ të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi _____

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):**Po**☐**Jo****X**Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

2.15 Pranohen variantet:**Po**☐**Jo****X****2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:****Po**☐**Jo****X**

Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:

(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)

2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:**Po**☐**Jo****X****Shënime të tjera** (nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po**X****Jo**☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;**Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST dhe****Stafi inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës 2.3.5 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.**

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për përvojën e mëparshme, licencat profesionale, stafin inxhinierik, pasi këto përbëjnë kapacitete të lidhura ngushtë me aftësinë teknike dhe organizativ të operatorit ekonomik që do të projektojë dhe zbatojë kontratën.

Objekti i kontratës kërkon që operatori ekonomik të ketë kapacitete të cilat garantojnë aftësinë për menaxhimin e projektimit, organizimin dhe realizimin e punimeve, respektimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe afateve kontraktore. Mbështetja në kapacitetet e një subjekti të tretë për këto elemente do të cenonte përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të kontraktorit dhe do të rriste rrezikun për mosrealizimin e suksesshëm të kontratës.

2.17 Vizitë në kantier

2.17.1 Do të organizohet një vizitë në kantier/konferencë paraprahe:

Po



Jo

X

2.17.2 Nëse po, të përcaktohet koha e zhvillimit dhe informacionet e nevojshme për të mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë apo paraqitjen e kërkesave të mundshme përsqarimenga ana e tyre:

_____ (dd/mm/vv)

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: *(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **10,000,000** (dhjetë milion lekë) **pa TVSH**

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ shuma, monedha

Loti 2 _____ shuma, monedha

3.1.2 Autoriteti/ Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor **Bashkia Himarë** (kodi i degës së Thesarit **2160001**)

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare ☐

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: ☐ 150 ditë (njqinde e pesedhjetë ditë)**Seksioni 4: Procedura****4.1 Lloji i procedurës: E hapur****4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:****Po**☐**Jo****X**

Nëse Po, numri i referencës është _____

4.2.1. Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).**Po**☐**Jo****X****4.3 Procedurë e rishpallur:****Po**☐**Jo****X**

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma, monedha)

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto ³ X****Sipas rëndësisë:**

- | | | |
|---|-------|----|
| 1. Çmimi | pikët | 50 |
| 2. Metodologjia/ Stafi / Organizimi i Kompanisë | pikët | 20 |
| 3. Eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike | pikët | 20 |
| 4. Grafiku i punimeve jo më shumë se 24 muaj | pikët | 10 |

³Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Metodologjia/ Stafi / Organizimi i Kompanisë

[0 –20 pikë]

1. Metodologjia [5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm.

Faktorët favorizues: Identifikoni dhe përshkruani faktorët që do të ndikojnë pozitivisht në realizimin e punimeve. Këto mund të përfshijnë përvoja të mëparshme të suksesshme, qasje inovative, ose bashkëpunime me partnerë të besueshëm. [0-1 Pikë]

Pajisje inovative: Prezantoni pajisjet dhe teknologjitë e avancuara që kompania juaj do të përdorë për të përshpejtuar dhe përmirësuar cilësinë e punimeve. Kjo mund të përfshijë makineri të reja, ose metoda të reja të ndërtimit. [0-2 Pikë]

Metodologji punimesh: Përshkruani metodologjitë dhe proceset që do të ndiqni për të siguruar që punimet të përfundojnë në kohë dhe me cilësi të lartë. Kjo mund të përfshijë planifikim të detajuar, menaxhim të efektshëm të burimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit. [0-2 Pikë]

2. Stafi / Organizimi i kompanisë

[15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori

duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike **[13 pikë]**

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

- I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin **[1 pikë]**
- II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin **[3 pikë]**
- III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin **[3 pikë]**
- IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. **[6 pikë]**

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi **[2 pikë]**

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

3. Eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike **[0–20 pikë]**

Kontratat e ngjashme, të realizuara me sukses gjatë 3 viteve të fundit janë një kriter mjaft i rëndësishëm për të vërtetuar se një OE ka aftësi teknike, ekonomike dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës, në kohë dhe çilesi. Eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike që janë realizuar me sukses orientojnë një OE i cili e ka me të lehtë për të realizuar në të ardhmen sesa një OE që nuk i ka zbatuar ndonjëherë. Për këtë arsye vlerësimi me pikë do të bëhet në mënyrë maksimale për ato OE që kanë punime dhe volume të kontratave të ngjashme me preventivin që prokurohet. Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

2.1 -Punime Transformimi urban në hapësira publike dhe ndërtim i shetitores me sipërfaqe jo më pak se 9,000 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit **[0-20 pikë]**

$Pk2.1 = Ok2.1 \times Pmaxk2.1 / Vmaxk2.1$

Pk2.1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmaxk2.1 ____ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (volumet e punimeve sipas kriterit të mësipërm)

Pmaxk2.1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok2.1 ____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nëpërmjet situacioneve perfundimtare .

Volumet specifike per kontrata te cilat nuk jane kolauduar nuk do te perfshihen ne perlllogartje. Permbushja e këtij kriteri do të provohet nëpërmjet situacioneve perfundimtare, aktit të kolaudit, dorezimit te detyrueshem te informacionit te përmbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

4. Grafiku i punimeve jo më shumë se 24 muaj

[0-10 pikë]

$Pk4 = Vmink4 \times Pmaxk4 / Ok4$

Pk4 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink4 ____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk4 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok4 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Përmbushja e këtij kriteri do të provohet nëpërmjet hartimit të grafikut të punimeve nga OE/BOE

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 04/09/2026 (d/m/v) ora 09:00

Vendi: app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42, pika 6, të LPP (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, argumentoni arsyt e shkurtimit të këtij afati:

--

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip ☒ Anglisht ☐

Seksioni 5: Informacione shtesë

5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po ☐ Jo ☒

Nëse po

Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomik të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme).

Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi

19/08/2026

FTESË PËR OFERTË

Bashkia Himarë, fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për realizimin e punimeve sipas preventivit në vijim:

.....
.....
.....

jepni një përshkrim të saktë të zërave të punimeve, specifikimeve teknike dhe sasisë konkrete të kërkuar):

Vendi i kryerjes së punës: (jepni një përshkrim të shkurtër) _____

Afati i realizimit të punimeve (sipas grafikut të punimeve): _____

Punimet duhet të realizohen brenda _____ ditëve/muajve nga data e fillimit të tyre.

Ofertat duhet të paraqiten në:

.....[jepni adresën e saktë]

Afati i fundit për pranimin e ofertave:

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Forma shkresore ☐

Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) ☐

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri Bashkia Himarë
Adresa Rr. "25 Marsi", nr.2; Spile, Himarë
Tel/Faks 039322355/039322533
E-mail info@himara.gov.al
Ueb-faqe www.himara.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur/ Pune.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-96684-08-19-2026

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Ndërtimi i pedonales Spile Saraçinko"

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45246500-8 Punime ndërtimi për shëtitore ; 71000000-8 Sherbime arkitektonike,inxhinierike,ndertimi dhe inspektimi

6. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 500,000,000 (pesëqindë milion lekë) pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Himarë i ndarë në tre vite financimi, konkretisht:

- Viti 2026 166,666,667 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) **pa tvsh.**
- Viti 2027 166,666,667 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) **pa tvsh.**
- Viti 2028 166,666,666 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë) **pa tvsh.**

7.Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Afati i kryerjes së investimit është 20 (njëzetë) muaj kalendarikë, 4 (katër) muaj për realizimin e projekt zbatimit.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 04/09/2026 Ora: 09:00

9. Procedurë e Rishpallur:

Po



Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

[Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I

KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

☐ Punë:

Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Numri i kontratës	Titulli i kontratës	Përshkrimi i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit : _____

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: _____

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit: _____

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve:

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: _____

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): _____

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri: _____

NIPT: _____

Adresa: _____

Kontaktet: _____

15.Data e nënshkrimit të modifikimit : _____

16. Burimi i financimit: _____

17.Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____

DOKUMENTAT E TENDERIT

Përmbajtja:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit të Kontratës.

Seksioni II: Shtojcat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës

Seksioni II përfshin formularët, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, Preventivi i punimeve, projektet e ndryshme teknike, Grafiku i punimeve,specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, termat e referencës apo detyrën e projektimit, nëse është rasti, që përshkruajnë punimet që do të prokurohen.

Seksioni III. Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Seksioni III përmban kushtet e përgjithshme dhe të vecanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e Sigurimit të Kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

Seksioni IV:Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME

- | | |
|--------------------------------|---|
| 1. Objekti i prokurimit | 1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës. |
| | 2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP). |

2. Operatorët Ekonomik të përshtatshëm	
---	--

a) "Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

1.1. të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;

1.2. BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të çojë në refuzimin e Ofertës.

3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit	
---	--

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

2. Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

3. Nëse autoriteti/enti kontraktor vendos të organizojë vizitë në terren/objekt, duhet ta parashikojë një gjë të tillë në Njoftimin e Kontratës. Të gjithë operatorët

ekonomikë, të interesuar për të marrë pjesë në tender, duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin epunës/ekzekutimit.

4. Nëse Autoriteti/Enti kontraktor do të organizojë një konferencë paraprake ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime për paqartësitë që u lindin gjatë përgatitjes së dokumenteve, duhet ta parashikojë një gjë të tillë në Njoftimin e Kontratës.

4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë siç është bërë publikimi i Dokumenteve të Tenderit.
3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e Ofertave, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e ofertave, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e ofertave me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

1. Shpenzimet e ofertimit

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

2. Gjuha e Ofertës

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

3. Dokumentet përbërëse të Ofertës

Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor.

-
- 4. Formularët e tenderit dhe preventivat eÇmimeve**
- Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.
- Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar
- 5. Ofertat Alternative**
- Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.
- 6. Çmimet**
1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.
 2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e OfertësEkonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).
- Kur autoriteti/enti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventivpor ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron, kontraktori paraqet vetëm ofertë ekonomike totale, në pamundësi për të paraqitur zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë apo çmimet e tyre.
3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.
 4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.
 5. Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

7. Monedhat	Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.
8. Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik	Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.
9. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës	- Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet. - Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërin nga format e mëposhtme: - Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor; - Garanci bankare; - Garanci sigurimi; Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës. - Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën. Nëse Autoriteti / Enti Kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë Operatori Ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.
10. Format i dhe Nënshkrimi i Ofertave	Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

11. Paraqitja e Ofertave	11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, Operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualin përkatës. 11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf
---------------------------------	--

jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për realizimin e punimeve; Njoftimi Nr. ____".

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA -
----- d/m/v, në orën-----” .**

12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave

Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

13. Ofertat me vonesë

Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës Sistemi i Prokurimit Elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

15. Hapja e Ofertave

Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

16. Konfidencialiteti

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

17. Sqarimi i ofertave

Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur

nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

18. Përgjegjshmëria e ofertave

1. Një ofertë e përgjegjshme/ vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit .

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik

1. Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku shprehet se, Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

